



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I FINANCËS

Nr. 2641 Prot

Klos, më 26 . 09 2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ .2023

“PËR SHTIM TË NUMRIT TË PUNONJËSVE REFERUAR PROJEKTIT “ME KOMUNITETIN PËR KOMUNITETIN” DHE DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E VITIT 2023”.

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, shkronja dh, në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.2493 Prot, datë.26.06.2023, “Trasferim fondesh për financim në ofrimin e shërbimit të përkujdesit në qarqe dhe bashki”, si dhe shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.2344/8 Prot, datë.14.06.2023, “Njoftim”, VKB nr.82, datë 21.12.2022, për “Miratimin e Buxhetit dhe numrin e punonjësve për vitin 2023”, në Udhëzimin e Ministrisë së Finanave nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrisë së Finanave nr.2, datë 19.01.2023, “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023”, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë,

VENDOSË:

1. Të shtojë numrin e punonjësve referuar projektit “Me Komunitetin Për Komunitetin”, përkatësisht:

- a) 1 shofer i punësuar me kohë të pjesshme
- b) 1 fizioterapist
- c) 1 punonjës social
- d) 1 psikolog
- e) 1 infermier

Pagat e këtyre punonjësve do të bazohen në buxhetin me të cilin bashkia Klos ka aplikuar dhe është përzgjedhur në kuadër të Fondit Social 2023.

2. Të bëhen këto ndryshime në buxhetin e vitit 2023:

a. Të pakësohet:

Gr	Kap	Prog	Llog	Kodi	Shuma	Emërtimi
00	01	01810	609	90005AA	637,929	Fondi Rezervë
			Totali		637,929	

b. Të shtohet

Gr	Kap	Prog	Llog	Kodi	Shuma	Emërtimi
00	01	10430	602	90005AA	637,929	Paketa e ndihmës për moshën e tretë (3 paketa për 150 të moshuar gjatë fazës së zbatimit të projektit “Me Komunitetin Për Komunitetin”)
			Totali		637,929	

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

Valbona KOLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

Relacion shpjegues Për Projekt-Vendimin, “Për shtim të numrit të punonjësve referuar projektit “Me Komunitetin për Komunitetin” dhe disa ndryshime në buxhetin e vitit 2023”.

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, shkronja dh, në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.2493 Prot, datë.26.06.2023, “Trasferim fondesh për financim në ofrimin e shërbimit të përkujdesit në qarqe dhe bashki”, si dhe shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.2344/8 Prot, datë.14.06.2023, “Njoftim”, VKB nr.82, datë 21.12.2022, për “Miratimin e Buxhetit dhe numrin e punonjësve për vitin 2023”, në Udhëzimin e Ministrisë së Finanave nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrisë së Finanave nr.2, datë 19.01.2023, “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023”, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të Bashkisë të vendosë:

1.Të shtojë numrin e punonjësve referuar projektit “Me Komunitetin Për Komunitetin”, përkatësisht:

- a) 1 shofer i punësuar me kohë të pjesshme
- b) 1 fizioterapist
- c) 1 punonjës social
- d) 1 psikolog
- e) 1 infermier

Bashkia Klos ka aplikuar për dhe është shpallur fituese për projektin “Me Komunitetin Për Komunitetin”, për ofrimin e shërbimeve multifunksionale për komunitetet në nevojë në bashkinë Klos.

Është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit nr.2615, datë 22.09.2023, ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Klos për zbatimin e projektit ‘Me komunitetin për komunitetin, përmirësimi dhe ofrimi i shërbimeve sociale për komunitetet në nevojë në Bashkinë Klos, mbështetur financiarisht nga programi i fondit social.

Marrëveshja është lidhur me afat 3-vjeçar me të drejtë rinovimi.

Kostoja totale e projektit është 24,511,147 lekë, ku kontributi i bashkisë është 9,704,096 lekë (798,152 lekë vitin e parë, 3,368,200 lekë për vitin e dytë dhe 5,546,775 lekë për vitin e tretë).

Shuma që do të financohet për projektin nga fondi social është 14,807,051 lekë.

Projekti është mbështetur në Planin Social të Bashkisë Klos për fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe administrative të shërbimeve të kujdesit shoqëror, shërbimet e kujdesit shoqëror dhe programet parandaluese, duke kontribuar në dy nivele :

- Ofrimin e shërbimeve në komunitet për grupet vunerabël
- Ofrimin e shërbimit social lëvizës me staf të specializuar.

Do mundsohet ndihmë për të gjithë target-grupet në nevojë duke filluar që nga ofrimi i, paketës së ndihmës, ofrimi i shërbimit social lëvizës me staf të specializuar deri te zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme argëtuese dhe kulturore.

Sa më sipër lind nevoja për shtimin e numrit të punonjësve të specializuar për ofrimin e shërbimeve në komunitet.

Pagat e këtyre punonjësve do të bazohen në buxhetin me të cilin bashkia Klos ka aplikuar dhe është përzgjedhur në kuadër të Fondit Social 2023.

2. Gjithashtu kërkojmë të bëjmë dhe ndryshim në buxhet për krijimin e fondit për pjesën e bashkëfinancimit që ka bashkia vitin e parë të zbatimit të projektit.

Të pakësojmë fondin rezervë me 637,929 lekë dhe të krijojmë zërin "Paketa e ndihmës për moshën e tretë (3 paketa për 150 të moshuar gjatë fazës së zbatimit të projektit).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Përgjegjës i Sektorit të Financës

Silvana Bala

